

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-KO- 013
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 22</i>

Rregulla për Publikimin e të Dhënavë të Tregut të Energjisë Elektrike

Maj 2018



**RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E
TË DHËNAVE TË TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

ver. 1.0

DT-KO- 013

faqe 2 nga 22

Përbajtja

1. Qëllimi.....	4
2. Përkufizimet	4
3. Dorëzimi dhe publikimi i të dhënave.....	6
4. Të dhënat bazë mbi ngarkesën e përgjithshme	7
4.1 Ngarkesa totale për periudhën kohore të tregut	7
4.2 Parashikimi i ngarkesës së përgjithshme për ditën në vijim për periudhën kohore të tregut	7
4.3 Parashikimi i ngarkesës totale për secilën ditë të javës së ardhshme	8
4.4 Parashikimi i ngarkesës totale për secilën javë të muajit të ardhshëm	8
4.5 Parashikimi i ngarkesës totale për secilin muaj të vitit të ardhshëm	8
5. Të dhënat mbi jo disponueshmërinë e njësive konsumuese	9
6. Parashikimi vjetor i marginës.....	9
7. Të dhënat mbi infrastrukturën e transmetimit	10
7.1 Zhvillimet në sistemin e transmetimit.....	10
7.2 Shkyçjet e planifikuara në sistemin e transmetimit.....	10
7.3 Shkyçjet e paplanifikuara në sistemin e transmetimit dhe rrjetin interkonektiv.....	11
8. Informatat mbi parashikimin dhe ofertën e kapaciteteve ndër-zonale	12
8.1 Parashikimi i Kapacitetit ndër – zonal	12
8.2 Kapacitetet e ofruara të transmetimit ndër-kufitar	12
8.3 Raportimi vjetor rrëth elementeve kritike të rrjetit që limitojnë kapacitetet e ofruara.....	12
8.4 Kapaciteti total i nominuar	13
8.5 Kapaciteti total i alokuar.....	13
8.6 Çmimet e ditës në vijim për kapacitetet e alokuara	13
8.7 Kapacitetet e ofruara të transmetimit ndër-kufitar në rastin e alokimit implicit	13
8.8 Totali i shkëmbimit tregtar për ditën në avancë	14
8.9 Rrjedhat fizike në linjat interkonektive	14
9. Tregtimi ndërkufitar për menaxhim të kongestionit	14
9.1 Menaxhimi i kongestionit.....	14

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>fazë 3 nga 22</i>
--	---	---

9.2	Tregtimi ndërkufitar	14
9.3	Raport i menaxhimit të kongestionit.....	15
10.	Të dhënat themelore të tregut për gjenerimin	15
10.1	Kapaciteti instalues i njësive gjeneruese	15
10.2	Kapaciteti i instaluar sipas njësive prodhuese.....	15
10.3	Plani i prodhimit total të energjisë elektrike për ditën në vijim	16
10.4	Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga era dhe fotovoltaikët	16
10.5	Prodhimi aktual (gjenerimi faktik) i energjisë elektrike	17
10.6	Planifikimi i shkyçjeve të njësive gjeneruese	17
10.7	Shkyçjet e paplanifikuara të njësive gjeneruese	18
11.	Balancimi.....	18
11.1	Rregullat për balancim	18
11.2	Sasia e rezervave balancuese të kontraktuara.....	18
11.3	Çmimet e kapacitetit rezervë të rezervave balancuese	19
11.4	Ofertat e pranuara totale.....	19
11.5	Sasia e rezervave balancuese të aktivizuara.....	19
12.	Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare	20

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>faza 4 nga 22</i>
---	---	---

Bazuar në Nenin 16, (parografi 1.34) dhe Nenin 23, (parografi 9.11 dhe 9.19) të Ligjit për Energjinë Elektrike si dhe Nenin 15 dhe 18 i Rregullores (KE) nr. 714/2009 Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energji ka miratuar këtë:

Rregulla për Publikimin e të Dhënavë të Tregut të Energjisë Elektrike

1. Qëllimi

- 1.1 Përmes kësaj Rregulle është definuar publikimi në kohën e caktuar i të dhënavë relevante mbi prodhimin, transmetimin dhe konsumin e energjisë elektrike që duhet të viven në dispozicion për pjesëmarrësit e tregut përfundimtarëve e tregut në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. Disponueshmëria me kohë e të dhënavë e rrit sigurinë e furnizimit me energji elektrike, me ç'rast u mundësohet palëve të tregut të përputhin kërkesën dhe ofertën duke redukuar rrezikun përfundimtarëve të energjisë elektrike
- 1.2 OST dhe palët tregtare duhet të informohen me kohë se kur dhe pse njësiti gjeneruese dhe të konsumit nuk janë në disponim dhe se kur pritet që ato të kthehen në funksion.
- 1.3 Në mënyrë që ta zvogëlojnë rrezikun e tyre përfundimtarëve, palët tregtare duhet të njoftohen me kohë me të dhënat relevante të tregut të energjisë elektrike mbi prodhimin, transmetimin, konsumin dhe tregun balancues.
- 1.4 Kjo rregull përcakton në mënyrë të detajuar obligimet përfundimtarëve të OST, OSSH, prodhuesit dhe njësitat e konsumit në lidhje me publikimin e të dhënavë të tregut. Për të mundësuar përshtatjen e portfoliove në përputhje me rrethanat, tregu duhet të pajiset me informata sa i përket mosfunkcionimit të planifikuar dhe të paplanifikuar të infrastrukturës aktuale interkonektive të transmetimit dhe planeve përfundimtarëve të zhvillimin e infrastrukturës.
- 1.5 Poashtu OST duhet të sigurojë të dhënat mbi kapacitetet e transmetimit dhe planet e zhvillimit të infrastrukturës si dhe të dhënat mbi kapacitetet ndërkufitarë të planifikuar dhe të alokuara të kapaciteteve përfundimtarëve.
- 1.6 Kjo Rregullë është e bazuar dhe në përputhje të plotë me Rreguloren e Komisionit Evropian Nr. 543/2013 mbi Transparencën, si dhe bazuar në kërkesat nga Rregullorja 714/2009.

2. Përkusizimet

Për qëllimin e kësaj Rregulle, do të përdoren definicione si në Rreguloren 714/2009, si në vijim:

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>fazë 5 nga 22</i>
--	---	---

- (1) “**alokimi eksplisit**” nënkupton alokimin vetëm të kapacitetit ndërzonale transmetues, pa përfshirë transferin e energjisë elektrike;
- (2) “**alokimi i kapaciteteve**” nënkupton atribuimin e kapaciteteve ndërzonale;
- (3) “**alokimi implicit**” nënkupton metodën e menaxhimit të konxhestioneve në të cilën energjia sigurohet në të njëjtën kohë me kapacitetin ndërzonale;
- (4) “**alokuesi i kapacitetit të transmetimit**” nënkupton subjektin e autorizuar nga OST për menaxhimin e alokimit të kapaciteteve ndërzonale;
- (5) “**balancimi ndërzonali i zonës së kontrollit**” nënkupton skemën balancuese në të cilën OST-të mund të marrin ofertë për aktivizim që vijnë nga zonat e OST-ve të tjera. Këtu nuk përfshihet ridispecimi ose shpërndarja e energjisë emergjente;
- (6) “**e planifikuar**” nënkupton një ngjarje të njojur *ex ante* nga zotëruesi primar i të dhënavë;
- (7) “**elementi kritik i rrjetit**” nënkupton një element të rrjetit brenda një zone ofertimi ose ndërmjet zonave të ofertimit i cili merret parasysh në procesin e llogaritjes së kapaciteteve, i cili kufizon sasinë e energjisë që mund të shkëmbitet;
- (8) “**faktori shpërndarës i transferit të energjisë**” nënkupton fluksin fizik në një element kritik shkaktuar nga ndryshimi i balancës së zonës së ofertimit;
- (9) “**kapaciteti i ofruar**” nënkupton kapacitetin ndërzonali të ofruar në treg nga alokuesi i kapacitetit të transmetimit;
- (10) “**kapaciteti i transmetimit neto i koordinuar**” nënkupton metodën e llogaritjes së kapaciteteve bazuar në parimin e vlerësimit dhe përcaktimit *ex ante* të shkëmbimit maksimal të energjisë në mes të zonave të afërta të ofertimit;
- (11) “**kapaciteti ndërzonali**” nënkupton aftësinë e sistemit të interkonektuar për të akomoduar transferimin e energjisë ndërmjet zonave të ofertimit;
- (12) “**koha e ndërprerjes**” nënkupton pikën në kohë ku OST duhet t'i konfirmoj të gjitha nominimet e përputhshme në treg. Koha e ndërprerjes i referohet jo vetëm tregjeve ditore ose ndërditore, por gjithashtu tregjeve të ndryshme që përfshijnë rregullimet e jobalanceve dhe alokimin e rezervave;
- (13) “**koha**” nënkupton kohën lokale në Bruksel;
- (14) “**kufiri elektrik**” nënkupton kufirin gjeografik ndërmjet një zone ofertimi dhe disa zonave të afërta/fqinje të ofertimit;
- (15) “**margjina e parashikuar për vitin në vijim**” nënkupton diferençën ndërmjet parashikimit vjetor të kapaciteteve gjeneruese në dispozicion dhe parashikimit vjetor të ngarkesës maksimale të përgjithshme, duke marrë parasysh parashikimin e kapacitetit të përgjithshëm të gjenerimit, parashikimin e gjenerimit në dispozicion dhe parashikimin e rezervave të kontraktuara për shërbimet ndihmese;
- (16) “**net gjenerimi**” nënkupton prodhiimin total aktual në prag të transmetimit dhe në prag të shpërndarjes në zonën kontrolluese brenda një intervali kohor. Ngarkesa aktuale në sistemin e transmetimit regjistrohet në serverin historik të SCADA sistemit dhe paraqitet lakuja në kohën reale.
- (17) “**ngarkesa totale**”, duke përfshirë humbjet pa energjinë e përdorur për deponimin e energjisë, nënkupton ngarkesën e barabartë me gjenerimin dhe çdo lloj të importit duke zbritur eksportet dhe energjinë e përdorur për deponimin e energjisë;

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>faqe 6 nga 22</i>
--	---	---

- (18) “ngarkesa vertikale” nënkupton sasinë e përgjithshme të energjisë që del jashtë rrjetit të transmetimit në drejtim të rrjetit të shpërndarjes, tek konsumatorët fundorë të lidhur drejtpërdrejt ose tek pjesa konsumuese e gjenerimit;
- (19) “njësi gjeneruese” nënkupton një gjenerator të energjisë elektrike i cili i përket një prodhuesi;
- (20) “njësi prodhuese” nënkupton objektin për gjenerimin e energjisë elektrike me një apo më shumë njësi gjeneruese;
- (21) “njësia e konsumit” nënkupton një njësi e cila konsumon energji elektrike për nevoja të veta, me përashtim të OST-se dhe Operatorëve të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-ve);
- (22) “njësia kohore e balancimit” nënkupton periudhën e kohës për të cilën është caktuar cmimi për rezervat balancuese.
- (23) “ofrues i të dhënave” nënkupton subjektin që i dërgon të dhënrat tek platforma qendrore e transparencës së informatave; “Periudha kohore e tregut” nënkupton periudhën në të cilën është vendosur cmimi i tregut ose periudhën e përbashkët më të shkurtër të mundshme për dy zona të ofertimit, në rast se periudhat kohore të tregut të tyre dallojnë nga njëra-tjetra;
- (24) “parametrat e bazuar në rrjedha” nënkupton marginën e disponueshme të elementeve kritike të rrjetit së bashku me faktorët e fuqisë së transferuar dhe shpërndarë;
- (25) “Platforma Qëndrore e Transparencës së Informatave” Platforma Qendrore e Transparencës së Informatave është një platformë elektronike në dispozicion për publikun, pa pagesë, me anë të internetit dhe është në dispozicion të paktën në gjuhën Angleze e krijuar nga Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji (ENTSO-E) në përbushje të detyrimeve të përcaktuara në Rregulloren e Komisionit Evropian Nr. 543/2013 e datës 14 qershori 2013.
- (26) “rezerva balancuese” nënkupton të gjitha kapacitetet në disponim për OST-në, që blehen ex-ante, ose në kohë reale, për qëllime të balancimit;
- (27) “ridispeçimi” nënkupton një masë e cila aktivizohet nga një ose disa operatorë të sistemit duke ndryshuar gjenerimin dhe/ose ngarkesën në mënyrë që të ndryshohen rrjedhat fizike në sistemin e transmetimit dhe të lehtësohen mbingarkesat (kongestionet) fizike;
- (28) “tregimi inderkufitar” nënkupton shkëmbimin ndërzononal të iniciuar nga operatorët e sistemit ndërmjet dy zonave ofertuese për lehtësimin e mbingarkesës fizike;
- (29) “valuta” është euro ose (monedhe zyrtare vendase) sipas detyrimit ligjor të përdorimit të se cilës prej tyre në aktet ligjore përkatëse;
- (30) “zona e kontrollit” nënkupton pjesën koherente të sistemit të interkonektuar, të operuar nga një operator i vetëm i sistemit dhe përfshin ngarkesa të lidhura fizike dhe/ose njësi të gjenerimit, nëse ka;
- (31) “zona e ofertimit” nënkupton hapësirën më të madhe gjeografike brenda të cilës pjesëmarrësit e tregut janë në gjendje të shkëmbejnë energji pa alokim të kapaciteteve;
- (32) “zotëruesi primar i të dhënave” nënkupton subjektin i cili i krijon të dhënrat;

3. Dorëzimi dhe publikimi i të dhënave

3.1.1 Zotëruesit primar të të dhënave i dorëzojnë të dhënrat tek Operatori i Sistemit të Transmetimit në përputhje me Rregulloren 543/2013. Zotëruesit primar të të dhënave

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>faqe 7 nga 22</i>
---	---	---

sigurojnë që të dhënat që i dorëzojnë tek OST të janë të sakta, të plota dhe që ti lejohet OST-së ti publikojë në webfaqen e KOSTT sh. a. (www.kostt.com). Kur është e domosdoshme, OST mundet t'i përpunojë të dhënat dhe pastaj ti dorëzojë tek ENTSO-E për publikim në momentin kur kërkohet.

- 3.1.2 Të dhënat mund të publikohen në webfaqen e OST-së ose palëve të tjera.
- 3.1.3 Zyra e Rregulatorit për Energji siguronë që zotërueshit primarë të të dhënavë, OST dhe ofrueshit e të dhënavë të respektojnë detyrimet e tyre sipas Rregullores 543/2013.

4. Të dhënat bazë mbi ngarkesën e përgjithshme

4.1 Ngarkesa totale për periudhën kohore të tregut

- 4.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, bën llogaritjen dhe publikon, ngarkesën totale për çdo periudhë kohore të tregut sipas formulës:

$$\text{Ngarkesa totale} = \text{gjenerimi neto} + \text{import} - \text{export}$$

- 4.1.2 Njësitë gjeneruese të kyçura në sistemin e transmetimit, duhet t'i ofrojnë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të gjitha informatat relevante të nevojshme për përllogaritjen e të dhënavë sipas paragrafit 4.1. Njësitë e gjenerimit konsiderohen si zotërueshit primarë të informatave relevante.
- 4.1.3 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet t'i dorëzoj OST të dhëna mbi prodhimin faktik të përgjithshëm të njësive gjeneruese të kyçura në sistemin e shpërndarjes për çdo periudhë kohore të tregut. OSSh konsiderohet si zotëruesh primarë i informatave relevante.
- 4.1.4 Informatat e dorëzuara sipas paragrafeve të mësipërm duhet të publikohen jo më vonë se një orë pas periudhës kohore të tregut.

4.2 Parashikimi i ngarkesës së përgjithshme për ditën në vijim për periudhën kohore të tregut

- 4.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikojë, të dhënat për vlerën e parashikuar të ngarkesës totale për ditën në vijim për periudhën kohore të tregut.
- 4.2.2 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i ofron OST-së të gjitha informatat relevante të nevojshme për të përllogaritur të dhënat sipas paragrafit 4.2.1.
- 4.2.3 Këto të dhëna do të publikohen jo më vonë se dy orë para kohës së mbylljes së tregut për ditën në vijim dhe përditësohen kur ndodhin ndryshime të rëndësishme.

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>Jaqe 8 nga 22</i>
---	---	---

4.3 Parashikimi i ngarkesës totale për secilën ditë të javës së ardhshme

- 4.3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikojë për zonën e vetë të ofertimit, të dhënat për vlerën e parashikuar të ngarkesës totale për secilën ditë të javës së ardhshme (W-1) ku çdo ditë duhet të përfshijë vlerën maksimale dhe minimale të ngarkesës totale.
- 4.3.2 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i ofron OST-së të gjitha informatat relevante të nevojshme për të përllogaritur të dhënat sipas paragrafit 4.3.1.
- 4.3.3 Këto të dhëna do të publikohen çdo të Premte jo më vonë se dy orë para kohës së mbylljes së tregut për javën në vijim por jo më vonë se ora 14.00 dhe përditësohen nëse ka ndryshime të rëndësishme.

4.4 Parashikimi i ngarkesës totale për secilën javë të muajit të ardhshëm

- 4.4.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikon të dhënat për vlerën totale të ngarkesës së parashikuar për secilën javë të muajit të ardhshëm (M-1), ku çdo javë duhet të përfshijë vlerën maksimale dhe minimale të ngarkesës totale.
- 4.4.2 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i ofron OST-së të gjitha informatat relevante të nevojshme për të përllogaritur të dhënat sipas paragrafit 4.4.1.
- 4.4.3 Këto të dhëna do të publikohen jo më vonë se një javë para muajit të dorëzimit dhe të përditësohen nëse ka ndryshime të rëndësishme.

4.5 Parashikimi i ngarkesës totale për secilin muaj të vitit të ardhshëm

- 4.5.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikojë të dhënat për vlerën totale të ngarkesës së parashikuar për secilin muaj të vitit të ardhshëm (Y-1), ku javët e secilit muaj duhet të përfshijnë vlerën maksimale dhe minimale të ngarkesës.
- 4.5.2 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i ofron OST-së të gjitha informatat relevante të nevojshme për të përllogaritur të dhënat sipas paragrafit 4.5.1.
- 4.5.3 Këto të dhëna do të publikohen jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit të ri kalendarak për të cilin kanë të bëjnë të dhënat.

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>fazë 9 nga 22</i>
---	---	---

5. Të dhënrat mbi jo disponueshmérinë e njësive konsumuese

- 5.1.1 Njësitë e konsumit të vendosura në zonën e kontrollit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit llogarisin dhe i dorëzojnë OST-së të dhënrat e përcaktuara sipas paragrafit 5.1.2.1 dhe 5.1.2.2. Njësitë e konsumit konsiderohen si zotërues primar të të dhënave që i dorëzojnë.
- 5.1.2 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, do të publikojë të dhënrat përmes:
- 5.1.2.1 Jo disponueshmérinë e planifikuar prej 100 MW ose më tepër të një njësie të konsumit duke përfshirë ndryshimet prej 100 MW e më tepër në jodisponueshmérinë e planifikuar të njësive të konsumit që zgjasin të paktën një periudhë kohore të tregut duke specifikuar:
- a) Zonën e ofertimit
 - b) Kapacitetin në dispozicion për periudhë kohore të tregut gjatë ngjarjes;
 - c) Arsyen e jo disponueshmërisë
 - d) Datën e parashikuar të fillimit dhe mbarimit (ditën dhe orën) të ndryshimit në disponueshmëri.
- 5.1.2.2 Ndryshimet në disponueshmérinë aktuale të njësisë së konsumit prej 100 MW ose më tepër duke specifikuar:
- a) Zonën e ofertimit
 - b) Kapacitetin në dispozicion për periudhë kohore të tregut gjatë ngjarjes;
 - c) Arsyen e jo disponueshmërisë
 - d) Datën e fillimit dhe datën e parashikuar të mbarimit (ditën dhe orën) të ndryshimit në disponueshmëri.
- 5.1.3 Informatat e përcaktuara nën 5.1.2.1 për zonën e ofertimit duke cekur shumën e kapacitetit të konsumit që nuk është në dispozicion gjatë një periudhe të caktuar, publikohen sa më shpejtë që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas marrjes së vendimit në lidhje me jodisponueshmérinë e planifikuar. Kurse për informatat e përcaktuara nën 5.1.2.2 duhet të publikohen jo më vonë se një orë pas ndryshimit të disponueshmërisë aktuale.

6. Parashikimi vjetor i marginës

- 6.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit do të llogaritë dhe publikojë përmes:
- a) Zonën e ofertimit, parashikimin vjetor të marginës, të vlerësuar për periudhë kohore të tregut.
 - b) Informatat duhet të publikohen një javë para alokimit vjetor të kapaciteteve, por jo më vonë se 15 ditë kalendarike të muajit para vitit me të cilin kanë të bëjnë të dhënrat.

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <small>ver. 1.0</small>	DT-KO- 013 <small>faza 10 nga 22</small>
---	---	--

- 6.1.3 Margjina e parashikuar për vitin në vijim përcaktohet si diferençë në mes të net gjenerimit vjetor të parashikuar dhe ngarkesës totale vjetore të parashikuar, duke marrë në konsiderim parashikimin e kapacitetit total gjenerues, disponueshmërinë e njësive gjeneruese dhe parashikimin për kapacitetin rezervë që do të kontraktohet për shërbimet ndihmëse.
- 6.1.4 OSSH dhe njësitë gjeneruese brenda zonës së kontrollit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, duhet ti dërgojnë të dhënat relevante të nevojshme për llogaritjen e të dhënave sipas paragrafit 6.1.1.

7. Të dhënat mbi infrastrukturën e transmetimit

7.1 Zhvillimet në sistemin e transmetimit

- 7.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të përgatitë dhe publikojë të dhënat për ndryshimet e ardhshme në elementet e rrjetit të transmetimit dhe rrjetin interkonektiv, për projektet në zhvillim duke përfshirë zgjerimin apo demontimin e ndonjë pjese të rrjetit të transmetimit brenda tre viteve të ardhshme. Kjo informatë duhet të jepet vetëm për ndryshimet në infrastrukturën e sistemit të transmetimit që mund të ketë ndikim prej së paku 100 MW në kapacitetin ndërzonala ndërmjet zonave të ofertimit. Kjo informatë duhet të përfshijë:
- a) Identifikimin e aseteve;
 - b) Lokacionin;
 - c) Llojin e asetit;
 - d) Ndikimi në kapacitetin e interkoneksionit sipas drejtimit ndërmjet zonave të ofertimit;
 - e) Koha e parashikuar e përfundimit.
- 7.1.2 Të gjitha këto informata duhet të publikohen një javë para alokimit vjetor të kapaciteteve por jo më vonë se 15 ditë kalendarike të muajit para vitit në të cilin kryhet alokimi. Informatat përditësohen me ndryshimet përkatëse para fundit të Marsit, Qershorit dhe Shtatorit të vitit në të cilin kryhet alokimi.

7.2 Shkyçjet e planifikuara në sistemin e transmetimit

- 7.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikojë të dhënat për shkyçjet e planifikuara në rrjetin e transmetimit duke përfshirë interkonektionin që mund të ndikon në zbritjen e kapacitetit ndërmjet zonave të ofertimit për 100 MW e më tepër dhe që mund të zgjasë minimum një periudhë kohore e tregut, duke specifikuar:
- a) Identifikimin e aseteve në fjalë;
 - b) Lokacionin;

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	D'T-KO- 013 <i>faqe 11 nga 22</i>
--	---	---

- c) Llojin e aseteve;
 - d) Vlerësimin sa ndikon kjo në kapacitetin ndërzononal dhe për drejtim ndërmjet zonave të ofertimit;
 - e) Arsyet e shkyçjeve; dhe
 - f) Koha e parashikuar e fillimit dhe mbarimit të ndryshimit (ditë, orë) të disponueshmërisë.
- 7.2.2 Këto të dhëna do të publikohen jo më vonë se një orë pas vendimit mbi shkyçjen e planifikuar.
- 7.2.3 OST mund të zgjedhë që të mos identifikojë asetet në fjalë dhe të mos specifikoj vendndodhjen e tyre, në rast se klasifikohet si informatë e ndjeshme.
- 7.3 Shkyçjet e paplanifikuara në sistemin e transmetimit dhe rrjetin interkonektiv**
- 7.3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikojë të dhënat për shkyçjet e planifikuara në interkonektion dhe në rrjetin e transmetimit që mund të ndikon në zbritjen e kapacitetit prej 100 MW e më tepër, që mund të zgjasë minimum një periudhë kohore të tregut, duke specifikuar:
- a) Identifikimin e aseteve në fjalë;
 - b) Lokacionin;
 - c) Llojin e aseteve;
 - d) Vlerësimin sa ndikon kjo në kapacitetin ndërzononal dhe për drejtim ndërmjet zonave të ofertimit;
 - e) Arsyet e shkyçjeve; dhe
 - f) Data e fillimit dhe data e parashikuar e mbarimit (ditë, orë) të ndryshimit të disponueshmërisë.
- 7.3.2 Këto të dhëna do të publikohen sa më shpejtë që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas ndryshimit në disponueshmërinë aktuale - shkyçjes së paplanifikuar.
- 7.3.3 OST mund të zgjedhë që të mos identifikojë asetet në fjalë dhe të mos specifikoj vendndodhjen e tyre, në rast se klasifikohet si informatë e ndjeshme.

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>fazë 12 nga 22</i>
--	---	--

8. Informatat mbi parashikimin dhe ofertën e kapaciteteve ndër-zonale

8.1 Parashikimi i Kapacitetit ndër – zonal

- 8.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Alokuesi i kapaciteteve të transmetimit (SEE CAO), për zonën e tij të kontrollit, do të llogarit dhe publikojë para procesit të alokimit informatat për:
- a) kapacitetin e parashikuar dhe ofruar (MW) për drejtim ndërmjet zonave të ofertimit në rast të alokimit të kapaciteteve bazuar në kapacitetin e koordinuar neto të transmetimit, ose
 - b) parametrat relevantë të bazuara në rrjedha, në rast të alokimit të kapaciteteve bazuar në rrjedha.
- 8.1.2 Informatat duhet të publikohen sipas afateve të përcaktuara në Shtojcë. Për NTC vjetore duhet të publikohen jo më vonë se 15 Dhjetori i vitit Y-1, për të gjithë muajt e vitit të ardhshëm. Informatat për NTC mujore duhet të publikohen jo më vonë se dy ditë pune para procesit mujor të alokimit, për të gjitha ditët pas muajit të ardhshëm M-1, kurse për NTC javore duhet të publikohen çdo të premte, për të gjitha ditët e javës së ardhshme.

8.2 Kapacitetet e ofruara të transmetimit ndër-kufitar

- 8.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, llogarit dhe publikon nëse ka alokime eksplikite, për çdo periudhë kohore të tregut dhe për drejtimin ndërmjet zonave të ofertimit, të dhënët si në vijim:
- a) kapacitetin (MW) e kërkuar nga tregu,
 - b) kapacitetin (MW) që i alokohet tregut,
 - c) çmimin e kapacitetit (vlera monetare/MW),
 - d) të ardhurat nga ankandet (në vlerë monetare) për kufirin ndërmjet zonave të ofertimit.
- 8.2.2 Informatat duhet të publikohen jo më vonë se një orë pas çdo alokimi të kapaciteteve.

8.3 Raportimi vjetor rrëth elementeve kritike të rrjetit që limitojnë kapacitetet e ofruara

- 8.3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, publikon një raport vjetor ku evidentohen:
- a) elementet kryesore kritike të rrjetit që kufizojnë kapacitetin e ofruar;
 - b) zonat e kontrollit të cilave u përkasin elementet kritike;
 - c) shkallën në të cilën lehtësimi i elementeve kritike të rrjetit do të rriste kapacitetin e ofruar;

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>faqe 13 nga 22</i>
--	---	--

- d) të gjitha masat e mundshme për zbatim për të rritur kapacitetin e ofruar, së bashku me parashikimin e kostove të tyre.
- 8.3.2 Gjatë përgatitjes së raportit, Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të zgjedh që të mos identifikoj asetet në fjalë dhe të mos specifikoj vendndodhjen e tyre, në rast se ajo është klasifikuar si informacion i ndjeshëm dhe kritik.

8.4 Kapaciteti total i nominuar

- 8.4.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikojë kapacitetin total të nominuar për çdo njësi kohore të tregut dhe për çdo drejtim ndërmjet zonave të ofertimit.
- 8.4.2 Informacioni duhet të publikohet jo më vonë se një orë pas çdo nominimi.

8.5 Kapaciteti total i alokuar

- 8.5.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, para çdo alokimi të kapaciteteve, publikon totalin e kapaciteteve të alokuara përmes procedurave të mëparshme të alokimit për njësi kohore të tregut dhe për çdo drejtim.
- 8.5.2 Informacioni duhet të publikohet sa po të ketë përfunduar dërgimi i të dhënavë sipas Shtojcës.

8.6 Çmimet e ditës në vijim për kapacitetet e alokuara

- 8.6.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, llogaritë dhe publikon për çdo njësi kohore të tregut, çmimet për ditën në vijim në zonën e vet përkatëse të ofertimit (€/MW).
- 8.6.2 Informatat publikohen jo më vonë se një orë pas kohës së mbylljes së tregut.

8.7 Kapacitetet e ofruara të transmetimit ndër-kufitar në rastin e alokimit implicit

- 8.7.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikon, në rastin e alokimit implicit, për çdo njësi kohore të tregut, pozicionet neto për çdo zone të ofertimit (MW) dhe të ardhurat e kongestionit (në vlerë monetare) në kufirin ndërmjet zonave të ofertimit.
- 8.7.2 Informatat duhet të publikohen çdo ditë, jo më vonë se një orë pas kohës së ndërpërjes dhe në rast se është e aplikueshme, përditësohet jo më vonë se dy orë pas çdo procesi të nominimit brenda ditës.

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE	DT-KO- 013
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 22</i>

8.8 Totali i shkëmbimit tregtar për ditën në avancë

- 8.8.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, llogaritë dhe publikon, shkëmbimet tregtare totale të skeduluara ndërmjet zonave të ofertimit për drejtim dhe njësi kohore të tregut.
- 8.8.2 Informatat duhet të publikohen çdo ditë, jo më vonë se një orë pas kohës së ndërprerjes dhe në rast se është e aplikueshme, përditësohet jo më vonë se dy orë pas çdo procesi të nominimit brenda dites.

8.9 Rrijedhat fizike në linjat interkonektive

- 8.9.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, llogaritë dhe publikon rrjedhat fizike të fuqisë ndërmjet zonave të ofertimit për çdo interval të llogaritjes në një ditë.
- 8.9.2 Informatat duhet të publikohen jo më vonë se një orë pas çdo intervali të llogaritjes për çdo njësi kohore të tregut, sa më afér kohës reale.

9. Tregimi ndërkufitar për menaxhim të kongestionit

9.1 Menaxhimi i kongestionit

- 9.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, publikon informatat në lidhje me ridispeçimin për njësi kohore të tregut, duke specifikuar:
 - a) veprimin e ndërmarrë (d.m.th rritjen ose uljen e prodhimit dhe ngarkesës),
 - b) identifikimin, vendndodhjen dhe llojin e elementeve të rrjetit që ka të bëjë me veprimin, arsyen e ndërmarrjes së veprimit, dhe
 - c) kapacitetin e ndikuar nga veprimi i ndërmarrë (MW).
- 9.1.2 Informatat duhet të publikohen sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit, përvèç për arsyet kur duhet të publikohen jo më vonë se një ditë pas periudhës së operimit.

9.2 Tregimi ndërkufitar

- 9.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, publikon informatat në lidhje me tregimin ndërkufitar për njësi kohore të tregut, duke specifikuar:
 - d) veprimin e ndërmarrë (d.m.th rritjen ose uljen e shkëmbimit ndërzonali),
 - e) zonën e ofertimit,
 - f) arsyen e ndërmarrjes së veprimit, dhe
 - g) ndryshime në shkëmbimin ndërzonali.



RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

DT-KO- 013

ver. 1.0

faqe 15 nga 22

- 9.2.2 Informatat duhet të publikohen sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit, përveç për arsyet kur duhet të publikohen jo më vonë se një ditë pas periudhës së operimit.

9.3 Raport i menaxhimit të kongestionit

- 9.3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, publikon informatat në lidhje me kostot mujore të tregtimit ndërzonale dhe ridispecimit dhe nga veprime tjera korrigjuese.
- 9.3.2 Informatat duhet të publikohen jo më vonë se dita e fundit e punës të muajit ($M+1$) pas muajit (M), në të cilën janë marrë veprimet e menaxhimit të kongestionit.

10. Të dhënat themelore të tregut për gjenerimin

10.1 Kapaciteti instalues i njësive gjeneruese

- 10.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikojë informatat për sasinë e kapacitetit total të instaluar të prodhimit (MW) për të gjitha njësítë gjeneruese me kapacitet të instaluar prodhues, të barabartë ose më të madh se 1 MW për secilin lloj të prodhimit.
- 10.1.2 Njësítë gjeneruese dhe njësítë prodhuese të cilët janë të kyçur në sistemin e transmetimit do ti dorëzojnë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhënat për kapacitetet gjeneruese të instaluara të njësive prodhuese në rrjetin e transmetimit sipas tipit te burimeve gjeneruese, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit të cilit i përkasin këto të dhëna.
- 10.1.3 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do ti dorëzojë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhënat për kapacitetin gjenerues të instaluar te njësive prodhuese në rrjetin e shpërndarjes, sipas tipit të burimeve gjeneruese, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit të cilit i përkasin këto të dhëna.
- 10.1.4 Informatat e mbledhura sipas tipit të prodhimit duhet të publikohen çdo vit jo më vonë se një javë para përfundimit të vitit.

10.2 Prodhimi sipas njësive prodhuese

- 10.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikojë informatat në lidhje me prodhimin e njësive prodhuese (ekzistuese dhe të planifikuar) me kapacitet gjenerues të instaluar të barabartë ose më të madh se 100 MW.
- 10.2.2 Informatat sipas paragrafit 10.2.1 duhet të publikohen për periudhën që mbulon tre vitet e ardhshme.
- 10.2.3 Njësítë prodhuese do ti dorëzojnë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit këto informata:

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>faqe 16 nga 22</i>
---	---	--

- a) Emrin e njësisë prodhuese;
 - b) Kapacitetin gjenerues të instaluar (MW);
 - c) Vendndodhjen;
 - d) Nivelin e tensionit në pikën e lidhjes;
 - e) Tipin e gjeneruesit; dhe
 - f) Zonën e ofertimit.
- 10.2.4 Njësitë prodhuese do ti dorëzojnë tek Operatori i Sistemit të Transmetimit informataat jo më vonë se dy javë përpara fillimit të vitit të cilit i përkasin këto të dhëna.
- 10.2.5 Të dhënat e pikës 10.2.3 publikohen çdo vit për tre vitet e ardhshme jo më vonë se një javë para fillimit të vitit të parë me të cilin kanë të bëjnë të dhënat.

10.3 Plani i prodhimit total të energjisë elektrike për ditën në vijim

- 10.3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikon informataat për planin e prodhimit total të energjisë elektrike në (MW) për zonën e ofertimit për ditën në vijim për çdo njësi kohore të tregut.
- 10.3.2 Prodhuesit e energjisë elektrike do të bëjnë nominimin e prodhimit të energjisë elektrike për ditën në vijim jo më vonë se ora 08.30. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikon të dhënat për prodhimin total të energjisë elektrike jo më vonë se ora 18,00.
- 10.3.3 Ri-dorëzimi i të dhënavëve do të bëhet në rast se duhet të bëhen korigjime të vlerave të mëparshme.

10.4 Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike nga era dhe fotovoltaikët

- 10.4.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit, për zonën e tij të kontrollit, do të llogaritë dhe publikon informataat për parashikimin e gjenerimit (MW) të energjisë nga era dhe dielli për zonën e ofertimit, për çdo njësi kohore të tregut të ditës në vijim.
- 10.4.2 Njësitë prodhuese nga dielli dhe era do të paraqesin këto të dhëna:
- a) vlera mesatare e parashikuar e energjisë së gjeneruar nga dielli për secilën njësi kohore të tregut, për çdo ditë;
 - b) vlera mesatare e parashikuar e energjisë së gjeneruar nga era për secilën njësi kohore të tregut, për çdo ditë.
- 10.4.3 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhënat e gjenerimit pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të mbledhura në sistemin e transmetimit për çdo tip të energjisë elektrike të pikës 10.4.2, jo më vonë se dita që paraprin ditën për të cilën kanë të bëjnë të dhënat (D-1), deri në orën 13:00.
- 10.4.4 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do ti dorëzojë të dhënat e përbledhura Operatorit të Sistemit të Transmetimit për çdo lloj të energjisë elektro-energetike të pikës 10.4.2 në sistemin e

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>faqe 17 nga 22</i>
--	---	--

shpërndarjes, jo më vonë se dita që paraprin ditën për të cilën kanë të bëjnë të dhënat (D-1), deri në orën 13:00.

- 10.4.5 Në bazë të dhënavë të paraqitura në pikën 10.4.2, të dhënat e mbledhura sipas pikes 10.4.1 do të dërgohen jo më vonë se ora 18.00, një ditë para se të kryhet dorëzimi. Informatat përditësohen rregullisht dhe publikohen gjatë ditës tregtare me së paku një përditësim që publikohet në orën 8.00, në ditën kur kryhet dorëzimi. Informatat sigurohen për zonën e ofertimit, në rast se ka më shumë se 5% furnizim të gjenerimit të energjisë nga era dhe ajo solare në vit.

10.5 Prodhimi aktual (gjenerimi faktik) i energjisë elektrike

- 10.5.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, llogaritë dhe publikon vlerën neto të prodhimit aktual (MW), për njësinë kohore të tregut (accounting interval) për ditën D.
- 10.5.2 Publikimi i të dhënavë do të bëhet për njësitë gjeneruese me kapacitet të instaluar prej 100 MW ose më tepër.
- 10.5.3 Njësitë prodhuese do të paraqesin të dhënat tek Operatori i Sistemit të Transmetimit sipas paragrafeve të mësipërm jo më vonë se 4 ditë (D+4) pas ditës (D) me të cilën lidhen të dhënat.
- 10.5.4 Të dhënat do të publikohen 5 ditë (D+5) pas ditës (D).

10.6 Planifikimi i shkyçjeve të njësive gjeneruese

- 10.6.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikon të dhënat për planifikimin e shkyçjeve të njësive gjeneruese për gjenerim baraz ose më të madh se 100 MW për çdo njësi kohore të tregut duke specifikuar emrin e njësisë prodhuese, njësinë gjeneruese, tipin, mungesën e kapacitetit prodhues (MW), datën e parashikuar të kyçjes kapacitetin në dispozicion gjatë ngjarjes, arsyen e shkyçjes apo ndaljes.
- 10.6.2 Prodhusit e energjisë elektrike do ti dorëzojnë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhënat për planifikimin e shkyçjeve të njësive gjeneruese për periudhën që përfshin deri në 1 vit.
- 10.6.3 Prodhusit e energjisë elektrike do ti dorëzojnë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhënat jo më vonë se një orë pas ndryshimit në disponueshmërinë aktuale.

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>faqe 18 nga 22</i>
---	---	--

10.7 Shkyçjet e paplanifikuara të njësive gjeneruese

- 10.7.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikon të dhënat për shkyçjet e paplanifikuara të njësive gjeneruese për prodhim baraz ose më të madh se 100 MW dhe që mund të zgjas së paku një njësi kohore të tregut.
- 10.7.2 Prodhuesit e energjisë elektrike do ti dorëzojnë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhënat për shkyçjet e paplanifikuara të njësive gjeneruese duke specifikuar emrin e prodhuesit, njësinë gjeneruese, tipin, mungesën e kapacitetit gjenerues (MW), datën e parashikuar të kyçjes kapacitetin në dispozicion gjatë ngjarjes, arsyen e shkyçjes apo ndaljes.
- 10.7.3 Prodhuesit e energjisë elektrike do ti dorëzojnë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhënat jo më vonë se një orë pas ndryshimit në disponueshmërinë aktuale.

11. Balancimi

11.1 Rregullat për balancim

- 11.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të rifreskon në baza të rregulla dhe bëjë të mundur dispozitat e aplikueshme të Rregullave për balancim.
- 11.1.2 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, publikon informatat në lidhje me rregullat për balancim që përfshijnë:
 - a) proceset për prokurimin e llojeve të ndryshme të rezervave balancuese dhe energjisë balancuese,
 - b) metodologjinë e pagesës për sigurimin e rezervave dhe energjinë e aktivizuar për balancim,
 - c) metologjinë e llogaritjes së çmimit të jobalancit, dhe
 - d) nëse është e zbatueshme, një përshkrim se si kryhet balancimi ndërkufitar ndërmjet dy ose më shumë zonave të kontrollit dhe kushtet e pjesëmarrjes së gjeneratorëve dhe ngarkesës.

11.2 Sasia e rezervave balancuese të kontraktuara

- 11.2.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikon informatat për sasinë e rezervave balancuese (MW) sipas kontratës nga OST.
- 11.2.2 Informatat që do të publikohen janë:
 - a) burimi i rezervave (gjenerim ose ngarkesë)
 - b) lloji i rezervave (p.sh. rezerva për rregullimin e frekuencës, rezerva për rivendosjen e frekuencës, rezerva për zëvendësim)
- 11.2.3 Informatat e përcaktuara duhet të publikohen sa më parë që është e mundur por jo më vonë se dy orë para se të mbylljet procesi i rradhës së prokurimit.

	RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE <i>ver. 1.0</i>	DT-KO- 013 <i>fazë 19 nga 22</i>
--	---	--

11.3 Çmimet e kapacitetit rezervë të rezervave balancuese

- 11.3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikon çmimet e paguara nga OST-të për llojin e rezervave balancuese të prokuarara dhe për periudhën e prokurimit (€/MW/periudha).
- 11.3.2 Të dhënat duhet të publikohen sa më parë që është e mundur por jo më vonë se një orë pas përfundimit të periudhës së operimit.

11.4 Ofertat e pranuara totale

- 11.4.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikon ofertat e pranuara të mbledhura për njësinë kohore të balancimit, veçmas për secilin lloj të rezervave të balancimit.
- 11.4.2 Të dhënat duhet të publikohen sa më parë që është e mundur por jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit.

11.5 Sasia e rezervave balancuese të aktivizuara

- 11.5.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikon sasinë e energjisë balancuese të aktivizuar (MW) për njësinë kohore të balancimit dhe për llojin e rezervave.
- 11.5.2 Informatat që do të publikohen janë:
- a) energjia balancuese e aktivizuar (MWh) në intervalin llogaritës,
 - b) lloji i energjisë balancuese të aktivizuar (sekondare dhe treciare)
 - c) burimi i rezervës së energjisë balancuese të aktivizuar (gjenerim ose ngarkesë),
 - d) drejtimi i rregullimit (rregullim për lartë ose rregullim për poshtë).
- 11.5.3 Informatat duhet të publikohen sa më shpejtë që është e mundur por jo më vonë se 30 minuta pas periudhës së operimit. Në rast se të dhënat janë preliminare, shifrat duhet të përditësohen atëherë kur të dhënat vihen në dispozicion.

11.6 Çmimet e paguara për energjinë e aktivizuar të balancimit

- 11.6.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikon çmimet e paguara nga OST për energjinë e aktivizuar të balancimit për njësinë kohore të balancimit dhe për llojin e rezervave. Informatat në lidhje me çmimin duhet të jepen ndarazi për rregullim për lartë dhe për rregullim poshtë.
- 11.6.2 Informatat duhet të publikohen sa më shpejtë që është e mundur por jo më vonë se një orë pas periudhës së operimit.



RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

ver. 1.0

DT-KO- 013

fazë 20 nga 22

11.7 Çmimet e jobalanceve

- 11.7.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikon të dhënat në lidhje me çmimin e jobalanceve (€/MWh) për njësi kohore të balancimit në ditën D.
- 11.7.2 Informatat duhet të publikohen sa më shpejtë që është e mundur

11.8 Vëllimi total i jobalanceve

- 11.8.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikon të dhënat në lidhje me vëllimin total të jobalanceve të zones së kontrollit për njësi kohore të balancimit.
- 11.8.2 Informatat duhet të publikohen sa më shpejtë që është e mundur por jo më vonë se 30 minuta pas periudhës së operimit. Në rast se të dhënat janë preliminare, shifrat duhet të përditësohen atëherë kur të dhënat vihen në dispozicion.

11.9 Bilanci mujor financiar

- 11.9.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit për zonën e tij të kontrollit, do të publikon të dhënat mbi bilancin mujor financiar të zones së vet të kontrollit, duke specifikuar:
 - a) shpenzimet që i janë shkaktuar OST-së për prokurimin e rezervave dhe aktivizimin e energjisë balancuese,
 - b) të ardhurat neto të OST-së pas shlyrjes së llogarive të jobalanceve me palët përgjegjëse për balancim.
- 11.9.2 Informatat duhet të publikohen sa më shpejtë që është e mundur por jo më vonë se 3 muaj pas muajit të operimit. Në rast se barazimi përfundimtar është preliminar, shifrat duhet të përditësohen pas barazimit përfundimtar final.

12. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

- 12.1.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikoj të dhënat e përcaktuara në pikat 4.1, 4.2, 4.3, 4.4, 4.5, 5, 10.1, 10.2, 10.3, 10.4, 10.5, 10.6 dhe 10.7 menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle.
- 12.1.2 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikoj të dhënat e përcaktuara në pikën 7 duke filluar nga data 1 Qershor 2018.
- 12.1.3 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikoj të dhënat e përcaktuara në pikat 6, 8, 9 dhe 11, pas plotësimit të kushteve për pjesëmarrje në alokimin e kapaciteteve interkonektive transmetuese rajonale.



**RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E
TË DHËNAVE TË TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

ver. 1.0

DT-KO- 013

faqe 21 nga 22

- 12.1.4 Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikoj të dhënat e përcaktuara në pikën 10.4 pas tejkalimit prej 5% të totalit të prodhimit vjetor të energjisë elektrike nga BRE-të.
- 12.1.5 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të dorëzojë të dhënat e përcaktuara sipas kësaj Rregulle tek Operatori i Sistemit të Transmetimit, menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle.
- 12.1.6 Prodhucesit do të dorëzojnë të dhënat e përcaktuara sipas kësaj Rregulle tek Operatori i Sistemit të Transmetimit, menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle
- 12.1.7 Operatori i Sistemit të Transmetimit, sipas kësaj Rregulle do të publikoj të dhënat në web faqen e KOSTT, ndërsa në përputhje me Rregulloren 543/2013 të dhënat do të dërgohen në ENTSO-E në momentin kur fillon implementimi i Marreveleshjes për Kyçje në ENTSO-E.
- 12.1.8 Kjo rregull hyn në fuqi menjëherë pas aprovimit nga Bordi i ZRrE-së dhe do të publikohet në webfaqen e ZRrE-së dhe në webfaqen e KOSTT sh.a.



**RREGULLA PËR PUBLIKIMIN E
TË DHËNAVE TË TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

ver. 1.0

DT-KO- 013

faqe 22 nga 22

Shtojca: Publikimi i informatave të referuara në pikën 8.1

Periudha e alokimit të kapaciteteve	Kapaciteti ndërzonali i parashikuar që duhet publikuar	Kapaciteti i ofruar që duhet publikuar
Vjetore	Një javë para procesit vjetor të alokimit, por jo më vonë se 15 dhjetor, për të gjithë muajt e vitit të ardhshëm	Një javë para procesit vjetor të alokimit, por jo më vonë se 15 dhjetor
Mujore	Dy ditë pune para procesit mujor të alokimit, për të gjitha ditët pas muajit të ardhshëm	Dy ditë pune para procesit mujor të alokimit
Javore	Çdo të premte, për të gjitha ditët e javës së ardhshme	Një ditë para procesit favor të alokimit
Për ditën në vijim		Një orë para mbylljes së portës së tregut të vendit, për çdo njësi kohore të tregut
Brenda ditës (intra-day)		Një ditë para alokimit të parë brenda ditës dhe pastaj në kohë reale, për çdo njësi kohore të tregut

Fundi i dokumentit